



**Republika e Kosovës**  
Komuna e Drenasit (Gllogoc)  
Kuvendi i Komunës

02 Nr. 020/04-7735 dt. 27/02/ 2026



Bazuar në nenin 11,12 dhe 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 34 të Statutit të Komunës së Drenasit. Ligji Nr. 04/L-071 për sistemimin e adresave, si dhe Udhëzimeve Administrative në fuqi. Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë 26.02.2026 miratoi këtë:

### **V e n d i m**

**Për Themelimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Drenasit.**

#### **Neni 1**

Më këtë Vendim miratohet në Kuvendin e Komunës themelimi i komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Drenasit në këtë përbërje:

1. Ekrem Elshani-Anëtarë
2. Qendresë Xhema-Anëtare;
3. Artian Krasniqi-Anëtarë;
4. Luljeta Elshani-Anëtare;
5. Xhavit Drenori-Anëtarë;

#### **Neni 2**

Komisioni për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Drenasit është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtimin e rrugëve dhe pas shqyrtimit të këtyre kërkesave dhe ankesave komisioni harton raportin dhe i propozon kuvendit listën për aprovim.

#### **Neni 3**

Mandati i komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Drenasit është katër (4) vjeçar ashtu sikurse anëtarët e Kuvendit si dhe përfundon me përfundimin e mandatit të anëtarëve të kuvendit.

#### Neni 4

Me këtë vendim obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor që të bëjë regjistrimin për emërtim të rrugëve që merr vendim kuvendi për ndryshim apo emërtim të ndonjë rruge të re.

#### Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi 30 (tridhjetë) ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit
- Palës



Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Burim Bujupi

## ARSYETIM

Komuna e Drenasit në harmoni me legjislacionin në fuqi i cili e rregullon këtë fushë ka për obligim emërimin dhe riemërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike, si rrjedhojë e të cilit proces është edhe themelimi i komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Drenasit ku duke marrë parasysh këtë Kryetari i Komunës përmes këtij propozim vendimi i propozon Kuvendit të Komunës që duke marrë parasysh legjislacionin në fuqi dhe nevojës për themelimin e komisionit në fjalë që synon adresimin dhe zgjedhjen e problemeve të kësaj natyre në nivel lokal të votohet ky propozim vendim.



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja  
Ministry of Environment and Spatial Planning

REPublika e Kosovës-REPublika KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANING	
Njësia Org. Org.Jedinica Org.Unit	DL
Nr.Prof. Broj.Prof. Prot.No	962-2/26
Nr. i faqeve Broj.stranica No.pages	-02-
Data Datum: Date	12.03.2026
PRISHTINE/A	

Për:	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Gllgocit
	Burim Bujupi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gllgocit
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër në MAPL
	Jeton Qela Sekretar i Përgjithshëm në MAPL
	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Fitore Pacolli Dalipi, Ministre në MMPH
	Izedin Bytyqi, U.D. Sekretar i Përgjithshëm në MMPH
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor në MMPH
	Date: 09.03.2026 VL 23/26
Zyrtarët përgjegjës:	
1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Arta Krasniqi - Zyrtare e Lartë Ligjore në Divizionin për Bashkëpunim Ndërinstitucional në Fushën e
2.Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Përfaqësimeve Gjyqësore dhe Koordinim të Marrëveshjeve
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit
Lloji i aktit:	Vendimi 02Nr.020/04-7735 për themelimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Gllgocit

I nderuar kryetar Lladrovci,  
I nderuar kryesues Bujupi,

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), në pajtim me nenin 9 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregullores (QRK) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, me datë 04.03.2026 ka pranuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Vendimin 02Nr.020/04-7735 për themelimin e Komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Gllgocit

MMPH pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me nenin 8, 9 dhe 10 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave konstatoi se:

Në Ligjin Nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave nuk është e rregulluar procedura për themelimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike. Ky akt lidhet me formimin e komisioneve të brendshme të organeve komunale, që janë të përcaktuara në legjislacion tjetër përkatës në fuqi.

Prandaj, MMPH vlerëson se nuk është kompetente për të dhënë vlerësim të ligjshmërisë lidhur me këtë vendim.

